

CHECK-IN ALBANIA

Duke u zhytur thellë në kufijtë jugorë të Shqipërisë, ndodhet qyteti mahnitës i Sarandës. I njohur kryesisht për ujërat e tij të thella dhe monumentet tërheqëse, qyteti mbetet një nga destinacionet turistike më të njohura që Shqipëria ka për të ofruar. Me të vërtetë përmban pothuajse çdo gjë që mund të kërkonte. Duke filluar nga mjediset natyrore magjepsëse deri te vendet arkeologjike shumë interesante. Me siguri fjalët tona nuk mund të përshkruajnë imtësisht bukuritë e këtij qyteti, kështu që shkoni dhe shikoni vetë magjinë. Mos i humbisni këto monumente mahnitëse:

Në jug të qytetit të Sarandës, në një kodër në gadishullin e Ksamilit ndodhet qyteti antik i Butrintit, i themeluar aty nga fillimi i shekullit të VII para Krishtit. Zona përreth qytetit antik në Shqipërinë e Jugut nuk është vetëm shtëpia e një numri specimesh të rrezikuara globalisht, por gjithashtu ka një histori të pasur kulturore që justifikon njohjen e tij si një vend i Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s.


Aty mund të gjeni edhe teatrin antik, monumentin më të rëndësishëm, duke e bërë Butrintin një atraksion turistik edhe më të mrekullueshëm që askush nuk duhet të humbasë kur viziton Sarandën.



BUTRINTI

Syri i Kaltër është një burim ujqor dhe fenomen natyror që çdo vizitor duhet ta shikojë dhe ndodhet në fshatin Muzinë. Ka vlera turistike, shkencore, estetike dhe rekreative. Edhe pse noti është ndaluar, në të vërtetë kjo gjë nuk i pengon njerëzit të hidhen drejt e në ujin e ftohtë. Së pari do të magjepseni nga pylli i dendur përreth dhe lumi i bukur blu që rrjedh nëpër këtë paradys natyror.

SARANDA



KALAJA E LËKURËSIT

Kalaja e Lëkurësit është një ndërtesë e shekullit të XVI. Kalaja ndodhet mes rrënojave të fshatit Lëkurës në majën e një kodre të lartë që ngrihet mbi qytetin e Sarandës. Ka një pozicion të veçantë strategjik nga ku mund të shihni të gjithë qytetin e Sarandës dhe rrugën që shkon në Butrint, gjithashtu mund të shijoni një panoramë të ishujve të Ksamilit. Është kthyer në një nga pikat turistike më të bukura dhe një nga më të frekuentuarat për çdo turist që viziton Sarandën.



SYRI I KALTËR

Manastiri i 40 Shenjtorëve ndodhet në lindje të Sarandës. Ai gjendet në vendin nga ku shihet e gjithë Saranda. Është ndërtuar në shekullin XV. Një mundësi më shumë për t'u zhytur në një atmosferë mistike.



XHAMIA E GJIN ALEKSIT



MANASTIRI I 40 SHENJTORËVE

Në brigjet e Jonit në Ksamil ndodhen Ishujt e Ksamilit, të cilët ju vendosin përballë një pamje mahnitëse të detit blu dhe ishujve të vegjël shkëmborë me bimësi të dendur e të egër. Janë ishujt e tij që e bëjnë Ksamilin kaq të veçantë, të dëshirueshëm dhe një zonë unike dhe shumë përfaqësuese të bregdetit shkëmbor shqiptar të Jonit.



ISHUJT E KSAMILIT

Një kuriozitet në vetvete është një xhami kushtuar një të krishteri. Quhet "Xhamia e Gjin Aleksit" dhe ndodhet së bashku me disa varre të shenjta myslimane në mes të fshatit Rusan, afër Delvinës. Xhamia është ndërtuar mbi rrënojat e një kisha në shekullin e 17-të dhe është ende funksionale.



PRODHIME DETI

Nëse shkoni ndonjëherë në Sarandë, duhet të provoni patjetër ushqimin. Ky qytet i mrekullueshëm bregdetar është i njohur për ruajtjen e traditave të ushqimit. Duke qenë pranë detit, Saranda dhe Riviera Shqiptare kanë qenë gjithmonë të mbushura me kulturën e peshkut dhe prodhimeve të detit. Me peshkatarët vendas që sjellin vazhdimisht peshkimin e tyre të ditës, ju jeni gjithmonë të garantuar se do t'ju shërbehen pjatat më të freskëta të prodhimeve të detit.

PËRGATITËN:

HERTA DANAJ, NOEL KILICA, RONI DIBRA, RUSHIT PLAKAJ, TAULANT SPAHIU, DEIVIS GUNI, ETNA GOXHAIJ, HERMES SINANI.